

Qeveria e Malit të Zi  
Ministria e Punëve të Jashtme

**S T R A T E G J I A**

**E BASHKËPUNIMIT ME DIASPORËN**

**PËR PERIUDHËN 2011-2014**

Podgoricë, 16 dhjetor 2010

# P Ë R M B A J T J A

## I HYRJA

## II MIGRIMET

## III DIASPORA E MALIT TË ZI

## IV QËLLIMET E STRATEGJISË

- Ruajtja dhe kultivimi i gjuhës, kulturës dhe traditës
- Mbështetja dhe forcimi i identitetit shtetëror dhe përkatësisë shtetit të Malit të Zi
- Rritja e komunikimit dhe informimit të ndërsjellë
- Promovimi i partneritetit ekonomik të shtetit amë (amzës) me diasporën
- Bashkëpunimi në fushën e shkencës dhe të arsimit
- Krijimi i stimulimeve sistemore dhe lehtësimeve për ata që kthehen
- Mbrojtja e të drejtave statusore dhe e pozitës së emigrantëve nga Mali i Zi në vendet pritëse
- Mbështetja e aktiviteteve sportive dhe aktiviteteve të tjera
- Diaspora si pjesëmarrëse aktive në jetën socio-ekonomike në Mal të Zi
- Inkurajimi i dhënies së donacioneve dhe formave të tjera të bamirësisë

## V KORNIZA INTITUCIONALE-JURIDIKE PËR BASHKËPUNIM ME DIASPORËN

## VI PLANI I VEPRIMIT

## VII MONITORIMI I REALIZIMIT TË STRATEGJISË DHE PLANIT TË VEPRIMIT

## I HYRJA

Miratimi i Strategjisë për bashkëpunim të Malit të Zi me diasporën bazohet në arsyet historike, juridiko-politike, ekonomike, kulturore dhe të natyrës humane, me arritjen e pavarësisë është njohur nevoja që çështja e bashkëpunimit me diasporën t'u përshtatet realiteteve dhe nevojave të reja të shtetit të Malit të Zi dhe diasporës së tij, dhe të rregullohet në mënyrë sistemore. Ky është hapi i parë në krijimin dhe zbatimin e një politike të re ndaj emigrantëve nga Mali i Zi, i cili duhet të rezultojë me përmirësimin e lidhjeve kulturore, arsimore, ekonomike, sportive dhe lidhjeve të tjera me shtetin amë (në tekstin e mëtejme: amza), avancimin e kujdesit të amzës ndaj diasporës, afirmimin e multietnicitetit dhe forcimin e identitetit qytetar dhe shtetëror të Malit të Zi. Lidhjet, marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me diasporën janë pjesë e pandashme e zhvillimit të brendshëm, si dhe proceseve të integrimi rajonale, evropiane dhe evroatlantike të Malit të Zi. Diaspora paraqet një lidhje të natyrshme shoqërore dhe kulturore me jashtë dhe një faktor shumë të rëndësishëm në promovimin dhe afirmimin e shoqërisë moderne malazeze. Obligim i Malit të Zi, në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore, është mbrotja e të drejtave të qytetarëve të vet jashtë vendit, zhvillimi dhe avancimi imarrëdhënies të emigrantëve me amzën dhe ofrimi i ndihmës diasporës malazeze, me qëllim që të ruhet dhe forcohet identiteti i tyre shtetëror, etnik, kulturor dhe gjuhësor. Me arritjen e pavarësisë Malit i Zi ka marrë përsipër edhe obligimet përkatëse ndërkombëtare lidhur me mbrojtjen e të drejtave dhe statusit të shtetasve të tij që jetojnë jashtë vendit. E gjithë kjo tregon për nevojën që në bashkëpunim me diasporën të ketë qasje pro-aktive dhe të përgjegjshme, si dhe një qasje multidisiplinare, duke krijuar strategji kombëtare reale për bashkëpunim me diasporën. Strategjia është hartuar në bazë të pasqyrimeve dhe njohurive të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe PDK-së, në bashkëpunim me ministrinë dhe organet tjera shtetërore, institucionet shkencore, qeverisjet lokale, Qendrën për Emigrantë, Amzën Malazeze, shoqatat e emigrantëve malazezë jashtë vendit dhe individët e shquar. Në përgatitjen e Strategjisë janë shfrytëzuar përvojat e vendeve me një numër të madh të diasporave (emigrantëve) dhe diasporave që janë më mirë të organizuara, të tilla si Izraeli, Irlanda dhe vende të tjera në rajonin tonë, dokumentet ndërkombëtare të cilat promovojnë diversitetet kulturore, ruajtjen e kulturës dhe gjuhës së popullit, si dhe dokumentet e tjera zhvillimore dhe strategjike të miratuara në Mal të Zi.

## II MIGRIMET

Migrimet e popullatës gjithmonë kanë qenë faktor nxitës për një zhvillim të civilizuar. Në fakt, historia e migrimeve është histori e luftës së përhershme të njerëzve dhe tendencës drejt progresit dhe prosperitetit të përgjithshëm. Moszhvillimi, kushtet e këqija të jetesës dhe pamundësia për punësim, janë arsyt kryesore për shkak të të cilave njerëzit vendosin të largohen nga vendi amë dhe të provojnë fatin në emigrim. Fjala është për dukuritë dhe proceset që i karakterizojnë të gjitha vendet, pa marrë parasysh shkallën e zhvillimit të tyre ekonomik. Natyrisht, një trend kanë patur migrimet për në vendet e zhvilluara, mirëpo edhe nga një vend në zhvillim në tjetrin, si dhe brenda vendeve të zhvilluara. Me një ndikim të pakontestueshëm në ndryshimin e strukturës së popullsisë, migrimet në kontinuitet kanë qenë faktor i zhvillimit të shteteve në të cilat kanë emigruar dhe posaçërisht kanë kontribuar në pasurimin e kulturave dhe civilizimeve. Në vendet e pranimit migrimet reflektojnë me plotësimin e nevojave për fuqi punëtore dhe po ashtu me kontributin në dinamikën intelektuale dhe kulturore të shoqërisë. Në vendet e prejardhjes, nga njëra anë, lënë mbrapa konskuenca ekonomike, sociale dhe të natyrave të tjera, kurse nga ana tjetër japin një kontribut të pakontestueshëm në zvogëlimin e varfërisë dhe në zhvillimin ekonomik të vendit të prejardhjes me vendosjen e lidhjeve afariste, transferin e njohurive, dërgesave, etj. Krahas ndihmesës financiare, përmes dërgesave dhe në mënyra të tjera, diaspora në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë participon në jetën politike, shoqërore dhe kulturore të amzës. Trendi botëror në bashkëpunimin mes vendit amë dhe diasporës është në inkurajimin e diasporës për të investuar në vendin e tyre të origjinës, tranferimi i njohurive të fituara dhe përvojës së tyre, për të krijuar dhe për të ndërtuar urat e bashkëpunimit mes vendit të pranimit me amzën. Në botë sot ekziston një numër i madh i emigrantëve të cilët janë bërë investitorë të suksesshëm në vendet e origjinës së tyre. Me investime kontribuojnë në rritjen e pasurisë kombëtare të vendit të origjinës, zhvillimin e ekonomisë, transferin e njohurive dhe përvojave, mentalitetit afarist, standardeve demokratike, gjegjësisht në ndryshimet e gjera të ambientit lokal dhe të ambientit të përgjithshëm socio-ekonomik. Tendenca është që imigrantët, veçanërisht ekspertët dhe sipërmarrësit në fushën e teknologjive të reja, kthehen me bizneset në vendin e origjinës. Në vend të ikjes së deritashme të "trurit" gjithnjë e më prezent është procesi i "Brain Gain", gjegjësisht kthimi i ekspertëve të kualifikuar nga vendet e migrimit, teknologjikisht të zhvilluara, në vendin e origjinës.

## III DIASPORA E MALIT TË ZI

Me termin „diaspora e Malit të Zi“ gjegjësisht „emigrantët malazez“ nënkuptohen shtetasit e Malit të Zi të cilët jetojnë jashtë vendit dhe të gjithë ata persona të cilët Malin e Zi e përceptojnë si shtetin e vet amë; Të cilët me Malin e Zi identifikohen në kuptimin shtetëror, kulturologjik dhe civilizues, pa marrë parasysh se a janë shtetas të Malit të Zi apo jo, se a janë pjesëtar të gjithë gjeneratave të emigrantëve, se a jeton në rajon, rrethinën e gjerë ose vendet tejoqeanike, se a janë pjesëtarë të kombit-etnicitetit malazez, ose janë pjesëtarë të popujve pakicë të cilët jetojnë në Mal të Zi, e të cilët punojnë në ruajtjen e Malit të Zi si shtet demokratik dhe qytetar, për forcimin e identitetit shtetëror malazez, i përkatësin shtetit të Malit të Zi, dhe punojnë në

rindërtimin kreativ të pasurive natyrore, shoqërore dhe shpirtërore në të tashmen dhe në të ardhmen. Edhe pse numri i saktë i emigrantëve malazezë dhe pasardhësve të tyre në mbarë botën nuk dihet, është i bazuar vlerësimi që duhet të jetë po aq i madh sa edhe numri i banorëve që jetojnë në Malin e Zi. Largimi i vazhdueshëm i popullsisë malazeze gjatë historisë është nxitur kryesisht nga shkaqet ekonomike, kushtet e dobëta materiale dhe të tjera, të cilat në faza të ndryshme të funksionimit të shtetit të Malit të Zi, kanë pasur shprehjen dhe dimensionin e tyre specifik. Emigrantët nga Mali i Zi, çka është karakteristikë e shteteve dhe kombeve të vogla, vështirë kanë arritur që të organizohen në mënyrë adekuate dhe të krijojnë kushte për promovimin e karakteristikave të veta kulturore, etnike dhe të tjera. Diaspora e Malit të Zi është në thelb komplekse dhe me shumë shtresa. Pjesën më të madhe të saj e përbëjnë pjesëtarët e popujve pakicë. Struktura me shtresa të shumta reflektohet në organizimin e saj të cilin e karakterizojnë fragmentimet, ndasitë dhe mungesa e komunikimit. Po ashtu edhe mungesa e formave adekuate të organizimit dhe lidhjeve të cilat do të pajtonin diversitetet dhe do t'u përgjigjeshin nevojave të diasporës si në vendin e pranimit, ashtu edhe ndaj Malit të Zi. Në gjendje e tillë për një periudhë të gjatë i ka kontribuar veprimtarisë së ndikimeve të ndryshme si nga Mali i Zi, po ashtu edhe nga vendet e rajonit tonë si një rezultat i proceseve që janë zhvilluar dhe po zhvillohet në këtë rajon. Së fundi, pas rivendosjes së shtetësisë, diversitetet dhe specifikat e natyrës së brendshme politike dhe të natyrave të tjera në Mal të Zi janë reflektuar edhe në diasporë dhe format e saj të organizimit. Shoqatat dhe asociacionet e emigrantëve nga Mali i Zi janë formuar kryesisht në mënyrë spontane, si përgjigje në ngjarjet në territorin e ish-RSFJ-së (Jugosllavisë), në përputhje me ligjet e vendeve pritëse dhe në shumicën e rasteve, deri me rivendosjen e shtetësisë, janë tubuar në bazë të linjës etnike, krahinore apo fetare. Kjo është një nga arsyt kryesore që as shoqatat tona, pavarësisht përpjekjeve faktike, kryesisht nuk kanë kapacitet që të ngriten si një faktor i tubimit më të gjerë dhe të organizimit më të mirë të diasporës. Më së shumti pjesëtarë të diasporës tonë jetojnë në vendete e Evropës Perëndimore, në SHBA dhe Kanada, si dhe në shtetet e krijuara në territorin e ish Jugosllavisë. Potencialet e tubuara njerëzore, intelektuale dhe të përgjithshme të diasporës me atdheun janë levë e zhvillimit të Malit të Zi. Koordinimi i mirë dhe menaxhimi i përbashkët i këtij potenciali, mes të tjerave, njërës nga parakushtet të prosperitetit të mëtejshëm socio-ekonomik të Malit të Zi dhe forcimit të identitetit të tij qytetar dhe shtetëror-kombëtar.

#### IV QËLLIMET E STRATEGJISË

Strategjia është pjesë e pandashme e strategjive për zhvillim dhe strategjive e politikave të tjera të Malit të Zi, qëllimi i të cilave është ruajtja dhe forcimi i marrëdhënieve gjithëpërfshirëse të amzës me diasporën. Me strategji, gjithashtu, definohen objektivat prioritare, bartësit e punëve dhe aktiviteteve, të cilat në periudhën deri në vitin 2013 dhe më tutje, duhet të krijojnë parakushtet e nevojshme për avancimin e bashkëpunimit me diasporën në mënyrë të sistemuar dhe kualitative, çka do të paraqesë inkurajim për diasporën në kërkimin e formave më të mira të organizimit dhe të komunikimit me amzën, do të jetë nxitje për potencialin kreativ në projektet me interes të dyanshëm, do t'i krijojë hapësirë diasporës që më lehtë të artikulojë nevojat e veta dhe të profilohet si një faktor për zhvillimin e brendshëm të Malit të Zi dhe të afirmimit të tij në planin ndërkombëtar. Strategjia është një vazhdim logjik i angazhimeve dhe aktiviteteve të cilat Qeveria e Malit të Zi ndërmerr pas rinovimit të shtetësisë në krijimin e formave dhe mekanizmave më të përshtatshëm të bashkëpunimit me emigrantët. Një prej objektivave është gjithashtu vendosja e

kornizës juridike dhe institucionale për bashkëpunim me diasporën për të realizuar aktivitetet të cilat janë të rëndësishme edhe për amzën edhe për diasporën.

Qëllimet prioritare të strategjisë janë:

## 1. Ruajtja dhe kultivimi i gjuhës, kulturës dhe traditës

### a) Gjuha

- Analiza e përfitimeve sistemore të cilat vendet pritëse, me dispozitat e veta ligjore ose në përputhje me konventat ndërkombëtare, u ofrojnë emigrantëve në drejtim të ruajtjes së tyre gjuhës amtare, karakteristikave kulturore dhe traditës, me nënshkrimin e marrëveshjeve dypalëshe në mënyrë që të krijohen kushtet juridike për zbatimin e plotë të standardeve ndërkombëtare në këtë fushë;

- Zhvillimi i programeve arsimore, teksteve shkollore përkatëse dhe materialeve të tjera didaktike për realizimin e mësimit plotësues të gjuhës amtare në komunitetet e imigrantëve, duke përfshirë edhe trajnimin e kuadrit mësime të shtetshëm për këtë formë të mësimit dhe definimit të detyrimeve të amzës dhe diasporës në këtë plan;

- Shqyrtimi i praktikës së deritashme të "Shkollës së gjuhës dhe kulturës së Malit të Zi" (të cilën që nga viti 2007 e organizon nga Qendra për Emigrantët në bashkëpunim me Entin e Arsimit), për të përmirësuar përmbajtjen dhe cilësinë e shkollës dhe përfshirjes sa më të madhe të fëmijëve të emigrantëve;

- Dizajni i të mësuarit të gjuhës në distancë me përdorimin e teknologjisë së informacionit modern.

### b) Kultura dhe tradita

- Afirmimi i kulturës dhe diversiteteve kulturore dhe promovimi i trashëgimisë kulturore dhe traditës në komunitetet e emigrantëve (organizimi i ekspozitave artistike, promovimeve të librave, koncerteve, folklorit dhe formave të tjera të krijimtarisë artistike, organizimi i simpoziumeve, tryezave të rumbullakta dhe manifestimeve të tjera);

- Nxitja e projekteve dhe programeve të diasporës me të cilat promovohet, nga njëra anë identiteti kombëtar dhe kulturor dhe nga ana tjetër, dallimet kulturore dhe dallimet e tjera si vërtetim i autenticitetit të këtij identiteti dhe afirmimit të Malit të Zi në planin ndërkombëtar, të avancohet bashkëpunimi kulturor me vendin pritës;

- Hulumtimi i historisë dhe trashëgimisë kulturore të emigrantëve malazetë dhe mbështetja e hulumtimeve të tilla në Mal të Zi dhe jashtë;

- Hapja e Qendrave të Kulturës së Malit të Zi në mjediset me numrin më të madh të popullatës emigrante;

- Formimi dhe rritja e fondit bibliotekar (botimet dhe titujt në gjuhët e popujve pakicë të cilët jetojnë në Mal të Zi me qëllim të ruajtjes së gjuhës dhe kulturës) në organizatat e mërgimtarëve dhe përfaqësitë diplomatike-konzulare.

## 2. Mbështetja dhe forcimi i identitetit shtetëror dhe përkatësisë shtetit të Malit të Zi

- Nxitja dhe inkurajimi në diasporë, i qasjes qytetare (civile) tashmë të pranishme në formimin e identitetit të veçantë kombëtar, gjegjësisht përkatësisë ndaj shtetit të Malit të Zi, në mënyrë identike siç e perceptojnë përkatësinë shtetit emigrantët në demokracitë e zhvilluara, pavarësisht nga origjina, përkatësia etnike apo fetare;

- Krahas respektimit të karakteristikave etnike, fetare dhe të tjera, të shtetasve të Malit të Zi, inkurajimi, forcimi dhe ndërtimi i pandërprerë i identitetit të pandashëm shtetëror, forcimi dhe afirmimi i ndjenjës së përkatësisë ndaj shtetit të Malit të Zi;
- Konstituimi i një strukture të re dhe moderne të emigrantëve e cila duhet të imponohet dhe të afirmohet si mbrojtëse dhe promovuese e interesave malazeze në vendin pritës, identitetin shtetëror malazez, si një faktor në avancimin e bashkëpunimit bilateral;
- Angazhimi i emigrantëve të njohur dhe me renome nga Mali i Zi, i shkencëtarëve, artistëve, sportistëve, afaristëve të suksesshëm dhe miqve të tyre dhe kontaktet në planin e promovimit dhe të afirmimit të interesave të Mali të Zi në rrafshin ndërkombëtar;
- Rritja e kapaciteteve të përfaqësive diplomatike-konzulare dhe hapja e përfaqësive të reja në vendet me numrin më të madh të emigrantëve malazezë;
- Themelimi i „Ditëve të diasporës së Malit të Zi“, që do të jetë një mundësi për tubimin e emigrantëve malazezë dhe aktualizimin e temave me rëndësi për statusin e diasporës;
- Përfshirja në projektin "Shtëpia malazeze" në mjediset me përqendrimin më të madh të emigrantëve tanë, nën kulmin e të cilit, në frymën e traditës më të mirë qytetare, multietnike dhe multifetare të Malit të Zi, do të tubohet diaspora, do forcohet identiteti shtetëror, do të hartoheshin dhe realizoheshin projekte me interes për diasporën dhe afirmimin e Malit të Zi;
- Themelimi i shpërblimeve dhe ndarja e mirënjohjeve emigrantëve të dalluar dhe organizatave të emigrantëve për rezultatet e arritura në bashkëpunim me amzën, si dhe indidëve dhe organizatave të dalluara në diasporë, të cilat kanë dhënë një kontribut të veçantë në vendosjen e kontakteve me Malin e Zi;
- Mbështetja e shoqatave ekzistuese të emigrantëve, qendrave të kulturës dhe formave të tjera të organizimit;

### 3. Rritja e komunikimit dhe informimit të ndërsjellë

- Avancimi dhe rritja e cilësisë së formave tashmë të përcaktuara të komunikimit dhe bashkëpunimit me diasporën (web portalet e internetit, e-mail diskutimet, posta elektronike, forumet dhe blogjet, revista Diaspora e Mali i Zi, botimi i revistave në fushën e kulturës, programet satelitore dhe të tjera televizive, radio emisionet dhe materialet e tjera audio-vizuele);
- Emërimi i përfaqësuesit të diasporës në këshillin programor të RTV të Malit të Zi (posaçërisht për koncipimin e programit Satelitor);
- Hartimi i regjistrit – bazës së të dhënave, evidentimi dhe dokumentat për emigrantët dhe organizatat e tyre, hartimi i publikimit „Kush është kush në diasporën e Malit të Zi“;
- Të sigurohet angazhimi i vazhdueshëm i Përfaqësive Diplommatike-Konzulare në punën me diasporën, mbështetja asociacioneve të diasporës në kërkimin e formave më të mira të organizimit dhe komunikimit me amzën;
- Hartimi i manualit informativ për diasporën, me të gjitha informatat relevante mbi të drejtat dhe detyrimet, proceset para organeve shtetërore, mbi jetën ekonomike, kulturore dhe politike të amzës, pasqyrimin e lidhjeve (linqeve) elektronike të dobishme dhe të tjera;
- Përgatitja dhe distribuimi i publikimeve dhe informatave mbi Malin e Zi,

trashëgiminë e tij historike, vlerat dhe të arriturat në fushët e kulturës, ekonomisë, aktualitetet dhe iniciativat nga Mali i Zi;

- Avancimi i bashkëpunimit dhe mbështetja e mediave që veprojnë në diasporë;

#### 4. Promovimi i partneritetit ekonomik të shtetit amë (amzës) me diasporën

- Analiza e strategjive dhe politikave të miratuara në Mal të Zi (të zhvillimit ekonomik, reduktimit të varfërisë, turizmit, energjetikës, shoqërisë informative, ndërtimitarisë, zhvillimit të qëndrueshëm, zhvillimit të sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe të tjera); shqyrtimi se a konsiderohet diaspora si një potencial për investime dhe zhvillim; shqyrtimi i projekteve aktuale për zhvillim, i ambientit afarist për realizimin e tyre, barrierave të mundshme në fushën e biznesit; propozimi i masave dhe mekanizmave për nxitjen e interesimit të sipërmarrësve nga diaspora që të investojnë mjetet drejtëpërdrejt ose përmes formave të partneritetit privat-publik;

- Evidentimi dhe botimi i mundësive për investime në sipërmarrjet e vogla dhe të mesme në sektoret e shërbimeve, bujqësisë, turizmit, mbrojtjes së mjedisit jetësor, energjetikës, infrastrukturës dhe të tjera, në pajtim me prioritetet themelore për zhvillim të Malit të Zi;

- Formimi i punktut gjegjës (pool-it) në nivelin shtetëror dhe lokal, i cili do të merrej me promovimin e projekteve, drejtimin e interesave, ofrimin e informatave dhe shërbimeve të nevojshme për afaristët nga diaspora të cilët janë të interesuar për investime dhe hapje të bizneseve në Mal të Zi;

- Analiza e gjendjes së kontraktuar në marrëdhënie me shtetet e veçanta, duke apostrofuar posaçërisht kontratat mbi shmangien e tatimeve të dyfishta, mbrojtjen dhe promovimin e investimeve (shtetet fqinje, SHBA, Kanada, shtetet e BE-së, Japonia, Rusia, Kina, India, Brazili dhe të tjera);

- Formimi i bazës së të dhënave mbi afaristët e origjinës sonë, ekspertët dhe specialistët e dalluar në universitete dhe qendra shkencore-kërkimore në mbarë botë;

- Mbatja, një herë në vit, e forumit të afaristëve nga diaspora dhe organeve më të larta shtetërore;

- Mbështetja profesionale dhe logjistike (materiali propagandistik, reklamat dhe të tjera) organizatave të mërgimtarëve, konsujve malazezë të nderit, në organizimin e promovimeve afariste, kulturore, turistike dhe të tjera në vendin pritës;

- Nxitja dhe mbështetja intitucionale në organizimin e diasporës në planin ekonomik (këshillat afariste, dhomat ekonomike dhe të tjera);

#### 5. Bashkëpunimi në fushën e shkencës dhe të arsimit

-Formimi i bazës së të dhënave të ekspertëve me arsim të lartë që jetojnë jashtë vendit, në universitete dhe institucione shkencore-kërkimore;

Përfshirja e njerëzve me arsim të lartë nga diaspora në programet arsimore dhe shkencore-kërkimore të cilat i organizojnë institucionet vendore, zgjidhja sistemore e çështjes së studimit dhe angazhimit të tyre profesional në institucionet nga të cilat ata u larguan në botë, duke vendosur informimin e ndërsjellë mbi mundësitë e pjesëmarrjes në konferencat shkencore dhe profesionale;

Krijimin e kushteve për studim në universitetet malazeze të popullsisë së re emigrante, si dhe të kushteve për përfitimin e bursës për studentët tanë, për ato në studimet e magjistraturës dhe doktoraturës, në vendet pritëse;

- Formimi i bazës së të dhënave të fondacioneve cilat u japin bursa studentëve



malazezë, të themeluara jashtë nga ana e emigrantëve tanë;

- Përcaktimi i mënyrave dhe modaliteteve të transferimit efektiv të njohurive dhe përvojave në drejtim të hapjes së bizneseve të vogla dhe të mesme në fushat e teknologjive më të reja, duke animuar ekspertët tanë dhe sipërmarrësit e angazhuar jashtë vendit në këtë fushë;

#### 6. Krijimi i stimulimeve sistimore dhe lehtësimeve për ata që kthehen

- Harmonizimi i dispozitave ligjore ekzistuese me rregullativën e BE-së, përvojat dhe praktikat e vendeve të rajonit, me të cilat emigrantëve që kthehen nga jashtë u sigurohen lehtësime doganore dhe tatimore në rastin e importit të mobiljeve shtëpiake, automjeteve dhe paisjeve për nisje e biznesit të vogël dhe të mesëm (efekti pozitiv i një vendimi të këtillë në diasporë duket shumë më i madhe krahasuar me efektet „negative“ buxhetore);

-Thjeshtimi, gjegjësisht shkurtimi i procedurës për fitimin e dokumentave personale dhe dokumentave të udhëtimit;

- Sugurimi i lehtësimeve administrative (lejeve-licencave, autorizimeve, çertifikatave, procedurave) në nivelin lokal;

- Hapja e një Departamenti të posaçëm në kuadër të Entit të Punësimit dhe Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Malit të Zi për personelin deficitar dhe të personelit me aftësi dhe përvoja të veçanta të cilat janë të nevojshme në procesin e integritimeve europiane dhe euro-atlantike dhe tregut të punës, dhe që mund të rekrutohen nga radhët e diasporës malazeze.

#### 7. Mbrojta e drejtave statusore dhe pozitës së emigrantëve nga Mali i Zi në vendet pritëse

- Monitorimi i të drejtave të arritura në fushën e të drejtave të njeriut dhe të pakicave të diasporës në vendet pritëse dhe marrja e masave për të përmirësuar statusim e saj me nënshkrimin e marrëveshjeve përkatëse, në përputhje me standardet më të larta ndërkombëtare;

- Analiza e dispozitave aktuale të vendeve pritëse me të cilat rregullohen dhe përcaktohen çështjet e caktuara (mësimi dhe ruajtja e gjuhës, kulturës dhe traditës, format e ndryshme të organizimit të diasporës dhe ngjashëm) dhe ofrimi i mbështetjes sistimore në këtë drejtim;

- Shqyrtimi i mundësisë dhe marrëveshjeve prioritare mbi shtetësinë e dyfishtë me shtetet e caktuara;

-Lehtësimi i procedurës për fitimin e shtetësisë malazeze, posaçërisht për pasardhësit e emigrantëve malazezë, personat e martuar me një shtetas malazez, fëmijët e lindur në martesë të përzierë dhe të tjera (me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit mbi shtetësinë malazeze).

#### 8. Mbështetja e aktiviteteve sportive dhe aktiviteteve të tjera

-Realizimi bashkëpunimit dhe koneksioni me organizatat sportive të emigrantëve dhe individëve të dalluar nga diaspora me asociacionet sportive dhe klubet nga Mali i Zi;

- Shkëmbimi i informatave, publikimeve profesionale dhe të literaturës nga fusha e sportit;

- Formimi i bazës së të dhënave mbi sportistët dhe veprimtarët e sportit me prejardhje-origjinë malazeze në diasporë.

## 9. Diaspora si pjesëmarrëse aktive në jetën socio-ekonomike në Mal të Zi

- Shqyrtimi dhe krijimin i kushteve juridike dhe të tjera që do t'u mundësojnë shtetasve malazezë në diasporë pozitën e pjesëmarrësit aktiv në zhvillimet socio-ekonomike në Mal të Zi;
  - Rritja e kapaciteteve të organizatave të diasporës në punët e diplomacisë publike me qëllim të promovimit të interesave shtetërore të Malit të Zi në nivelin më të lartë të vendimmarrjes në vendin pritës;
  - Përdorimi i kontakteve të diasporës për të krijuar bashkëpunim mes komuniteteve lokale të vendit të origjinës me ato vendit pritës-tween cities (qytetet binjake);
  - Inkurajimi dhe afirmimi i marrëdhënieve aktive të autoriteteve shtetërore, sidomos të komuniteteve lokale-komunave ndaj diasporës së vet, iniciativat që vinë nga diaspora për të krijuar një mjedis të favorshëm biznesi (përcaktimi i zonave industriale, masat dhe mekanizmat stimuluuese tatimore dhe lehtësimi i taksave në nivel lokal, etj.)
  - Takimet dhe bisedimet me rastin e vizitave të autoriteteve shtetërore nga Mali i Zi.
  - Formimi i Kuvendit të Diasporës (do ta përbënin përfaqësuesit e diasporës), i cili do të kishte këshillat si grupe punuese të përhershme (p.sh. Këshilli për bashkëpunimin tregtar-ekonomik, këshilli për çështjet e statusit të diasporës, këshilli për bashkëpunimin kulturor, shkencor, sportiv dhe bashkëpunime të tjera).
10. Inkurajimi i dhënies së donacioneve dhe formave të tjera të bamirësisë
- Inkurajimi i dhënies së donacioneve dhe aktiviteteve të tjera humanitare të diasporës drejtuar amzës.

## V KORNIZA INSTITUCIONALE-JURIDIKE PËR BASHKËPUNIM ME DIASPORËN

- Formimi i një zyrës së posaçme të qeverisë apo agjencisë për diasporën, në përputhje me përvojat e vendeve të tjera në rajon. Zyra/Agjencia, e krijuar me transformimin e Qendrës ekzistuese për emigrantët dhe forcimin e kadrovik dhe material të saj, me bashkëpunimin me institucionet dhe organet ekzistuese, në komunikim me diasporën, me një qasje ndërsektoriale dhe përmes komisioneve përkatëse (për arsim, ruajtje të gjuhës, kulturës dhe traditës, bashkëpunim në fushën e biznesit, bashkëpunim ekonomik dhe teknik, etj.) ka përgatitur programe dhe projekte dhe ka artikulluar interesat e Malit të Zi ndaj diasporës dhe anasjelltas;
- Hartimi i ligjit të posaçëm me të cilin do të rregullohej çështja e bashkëpunimit me diasporën dhe korniza institucionale, si dhe kompetencat dhe marrëdhëniet e ndërsjella midis organeve dhe institucioneve në realizimin e këtij bashkëpunimi, në përputhje me standardet më të larta dhe praktikat më të mira, posaçërisht të vendeve të rajonit;
- Formimi, në përputhje me përvojat komparative dhe praktikën e mirë, të Këshillit për Diasporën, si një organ këshillëdhënës i Zyrës/Agjencisë për Diasporën, të cilim do ta përbënin përfaqësuesit e ministrive dhe institucioneve përkatëse, kurse të njëjtin do ta kryesonte kryetari i Malit të Zi.
- Formimi i trupit të posaçëm punues të Kuvendit të Malit të Zi për bashkëpunim me diasporën.

## VI PLANI I VEPRIMIT

Pjesë përbërëse e kësaj Strategjie është edhe Planin e Veprimit për realizimin e saj, i cili përmban propozimin e aktiviteteve dhe masave konkrete, bartësit e punëve dhe afateve për realizim. Me Planin e Veprimit është paraparë që aktivitetet e planifikuara të realizohen në kuadër të punëve të rregullta nga fushëveprimi i punës së organeve dhe institucioneve përkatëse, për të cilat me Buxhet sigurohen mjetet e nevojshme secilin vit. Gjithashtu, me plan është paraparë që disa nga aktivitetet të organizohen në bazë të projekteve dhe që për realizimin e tyre të kërkohen mjete nga sponsorët dhe donatorët.

## VII MONITORIMI I REALIZIMIT TË STRATEGJISË DHE PLANIT TË VEPRIMIT

Zyra/Agjencia për Diasporën, me mbështetjen e Ministrisë së Punëve të Jashtme, është përgjegjëse për monitorimin dhe realizimin e Strategjisë dhe të Planit të Veprimit. Në këtë kuptim, deri në krijimin e kushteve që Zyra / Agjencia për diasporën të funksionojë me kapacitet të plotë, Ministria e Punëve të Jashtme do të koordinojë aktivitetet dhe do të publikojë të dhënat relevante dhe informatat në lidhje me aspektet kyçe të zbatimit të Strategjisë (projektet, dokumentet, konferencat shtetërore dhe ndërkombëtare, donatorët e mundshëm, konkurset, takimet e mërgimtarëve, etj. Zyra/Agjencia për Diasporën rregullisht do t'ia parashtojë qeverisë raportin mbi realizimin e Strategjisë.